

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2458/ Prot.

Durrës, më 27.10.2025

V E N D I M

Nr. 81, Datë 27.10.2025

P Ë R

**"MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER
PROFESIONAL 2- VJEÇAR NË "SPECIALIST DOGANOR DHE I LOGJISTIKËS
TREGTARE", PRANË FAKULTETIT TË STUDIMEVE PROFESIONALE, TË
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin e UAMD-së ; në Rregulloren e UAMD-së ; në shkresën e Drejtuesit të Njesisë Kryesore të FSP me nr. 2099 prot., datë 17.09.2025, si edhe në relacionin Nr. 2099/1 prot., datë 06.10.2025 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, vendimin e Senatit Akademik nr.117, datë 24.10.2025, Bordi i Administrimit

V E N D O S I :

1. Miratimin e tarifës së programit të studimit me karakter profesional 2- vjeçar në "Specialist Doganor dhe i Logjistikës Tregtare", pranë Departamentit të Studimeve të Integruara me Praktikën, në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2026-2027.
2. Tarifa për këtë program studimi do të jetë 25.000 lekë.

3. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën **Shqipe**.
4. Kodi i programit të studimit: **52 PP 0488 S**.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TE ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

